



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 193/2 Prot.

Tiranë, më 19.7 2021

URDHËR

Nr. 230, Datë 19.7.2021

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR” NË
“BIZNES DHE TREGTI ELEKTRONIKE”, NË UNIVERSITETIN E NEW YORK
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Biznes dhe Tregti Elektronike” me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Bachelor” në “Biznes dhe Tregti Elektronike”, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit, në Universitetin e New York Tiranë, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Biznes dhe Tregti Elektronike”, në Universitetin e New York Tiranë, fillon në vitin akademik 2021-2022.
3. Universiteti i New York Tiranë të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti i New York Tiranë të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI

